KRONIKË E ZEZË

Të veshur në uniformë ushtarake kanosën dy kalimtarë, arrestohen tre të dyshuarit

16 janar 2023, 22:42

Shpërndaje në

Policia e Kosovës në rajonin e Prizrenit ka njoftuar se ka arrestuar tre të dyshuar, të cilët të veshur në uniformë ushtarake kishin kanosur dy kalimtarë, një burrë dhe një grua, në rrugën Pouskë-Prizren.

Policia ka njoftuar se të hënën të dyshuarit janë arrestuar në fshatin Pouskë dhe se atyre u janë konfiskuar 6 armë dhe municione.

"Më datë 16.01.2023 në ora 00:10, dy viktimat raportojnë se me date 15.01.2023 , rreth orës 23:10 ishin kanosur me armë derisa ishin duke lëvizur se bashku me veturën e tyre. Ata ishin kanosur në rrugën e fshatit Pouskë-Prizren. Sipas deklaratës së të dëmtuarve, atyre u kishin dal para tre persona të dyshuar, të veshur me uniforma ushtarake, të armatosur dhe nuk kishin lejuar që të vazhdonin rrugën tutje duke i kthyer pas", thuhet në njoftimin e Policisë.

Në lidhje me këto informacione të pranuara, hetuesit e Stacionit policor në Prizren kanë filluar hetime preliminare në drejtim të ndriçimit të rrethanave të rastit.

"Pas një pune hetimore intensive në lidhje me rastin në fjalë, është arrit të sigurohet informacion i vlefshëm , në drejtim të identifikimit të një prej dyshuarve që dyshohet ka kryer këtë vepër. Fillimisht një i dyshuari është shoqëruar ne stacionin policor Prizren, ku pas ballafaqimit me informacionin dhe dëshmitë e siguruara, ka pranuar që së bashku me dy dyshuarit tjerë e kanë kryer veprën penale", thuhet në njoftim.

Për këtë thuhet se është informuar prokurori kujdestar, departamenti për krime të rënda , i cili ka dhënë urdhër për bastisjen e shtëpive të tre të dyshuarve, me qëllim të gjetjes së dëshmive të tjera , që lidhen me rastin në fjalë.

"Gjatë këtyre bastisjeve në fshatin Pouskë, janë gjetur dhe sekuestruar municion, rroba kamuflazh (ushtarake), si dhe armët e shënuara si me poshtë: 1 pushkë automatike AK-47, 1 pushkë gjuetie 'Magnum' , 1 pistoletë 'Walter CP 88', 2 pushkë gjuetie, 1 pistoletë plastike – shkrepëse, ngjyra e zezë, me mbishkrimin 'DESERT EAGLE'. Pas bastisjeve të kryera dhe dëshmive të gjetura dhe sekuestruara është informuar prokurori kujdestar për krime të renda, ku ndaj tre të dyshuarve ka udhëzuar që të ngritët kallëzim penal për veprat penale 'Kanosje', 'Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armeve dhe municionit' dhe 'Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm'", thuhet në njoftimin e Policisë.

Deklaratat e të dyshuarve thuhet se janë marrë në prezencën e avokateve të angazhuar nga të dyshuarit. "Prokurori ka lëshuar aktvendim mbi ndalimin e tre të dyshuarve për 48 orë", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#ARRESTOHEN #KALIMTARE #KANOSEN #POLICIA #PRIZREN #TRE TË DYSHUJAR #UNIFORME USHTARAKE

Gruaja rrah bashkëshortin në Prishtinë, viktima merr trajtim mjekësor
Malaziasi tenton t'ia japë 5 euro ryshfet policit kosovar, arrestohet
Burri nga Podujeva e raporton nipin për vjedhje
Godet këmbësoren me veturë, arrestohet i dyshuari dhe dërgohet në mbajtje
Tre persona e grabitin një veturë nën kërcënim të armës, aksidentohen me të
Dy të lënduar në aksidentin në Shakovicë
Arrestohet Fero

TabOola Feed

AI Courses Might Be Cheaper Than You Think
Artificial Intelligence Course | Search Ads | Sponsored

Used Car Prices in Albania Might Be Lower than You Think
Used Car Prices | Search Ads | Sponsored

15 vjet burgim personit që e rrahu për vdekje bashkëshorten në Samadrexhë

Gjykata Themelore në Prizren e ka dënuar të hënën me 15 vjet burgim të akuzuarin I.H., që dyshohet se më 31 maj të 2019-s, e kishte rrahur për vdekje bashkëshorten e tij, viktimën …

Kohanet

If you own a mouse, you have to play this game. No Install. Play for free.
CombatSiege | Sponsored

TË TJERA

Morën para duke u premtuar grante dy aplikuesve, arrestohen të dyshuarit

Arrestohet i dyshuari që shtiu me armë në ajër për ta frikësuar mikun

Dy të lënduar në aksident mes tri veturave në Kijevë

Arrestohet në Fushë-Kosovë një person i dyshuar për disa vjedhje

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

KOHA
Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.